
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Data: 27.04.2026

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - MALLRA

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Objekti i procedurës: “Blerje vaksina kundër sëmundjes së plasjes” dhe “Blerje e alergenëve tuberkulinë bovinë dhe aviare për kontrollin e tuberkulozit në gjedh” për AKVMB-në, ndarë në 2 (dy) lote.

Loti 1: “Blerje e vaksinave kundër sëmundjes së plasjes për AKVMB-në”.

Loti 2: “Blerje e alergentëve tuberkulinë bovinë dhe aviare për kontrollin e tuberkulozit në gjedh për AKVMB-në” .

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): 33651600-4 Vaksina.

Vlera e fondit limit: **15,944,552** (pesëmbëdhjetë milion e nëntëqind e dyzet e katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH**, e ndarë në lote:

Loti 1: “Blerje e vaksinave kundër sëmundjes së plasjes për AKVMB-në”, me fond limit: **4,264,884** (katër milion e dyqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH**.

Loti 2: “Blerje e alergentëve tuberkulinë bovinë dhe aviare për kontrollin e tuberkulozit në gjedh për AKVMB-në”, me fond limit: **11,679,668** (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) **lekë pa TVSH**.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Loti 1: “Blerje e vaksinave kundër sëmundjes së plasjes për AKVMB-në”.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit të lotit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) *40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”*. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”*.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit të këtij loti është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit të lotit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 55, pika 4 (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit të lotit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik, për vaksinat e ofruara, mund të jetë prodhues i tyre. Në rast se nuk është prodhues, duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi. Në rastin e paraqitjes të kësaj të fundit duhet të paraqitet një dokument që vërteton lidhjen midis Distributorit dhe Prodhuesit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se janë prodhues ose kanë mundësinë të marrin vaksinën e ofruar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi. Gjithashtu nëpërmjet këtij kriteri operatorët ekonomikë dëshmojnë se ofrojnë një produkt origjinal të prodhuar sipas kërkesave të Komisionit Shtetëror të PMV-ve, bazuar në Ligjin Nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë të detajuar me të dhënat përkatëse të kompanisë prodhuese si emri tregtar, vendi i ushtrimit të aktivitetit, email etj, si dhe dokumentacion që konfirmon statusin ligjor/certifikatën e regjistrimit të prodhuesit, ku të specifikohet se certifikata e tregtimit, për dozat e vaksinës të ofruara, është lëshuar nga Agjencia Europiane e Medikamenteve (EMA) ose në një nga vendet e BE, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Neni 85, pika 3.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në republikën e Shqipërisë”, Kreu VII “Produktet mjeksore veterinare”, Seksioni 1 “Autorizimi për tregtimin e produkteve mjekësore veterinare”, Neni 85 “Tregtimi i produkteve mjekësore veterinare”, pika 3, ku përcaktohet:

“Komisioni Shtetëror i PMV-ve njeh dhe pranon certifikatën e tregtimit për PMV-të, lëshuar nga Agjencia Europiane e Medikamenteve (EMA) ose në një nga vendet e BE-së”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se do të ofrojnë një vaksinë e cila njihet dhe lejohet të tregëtohet në Republikën e Shqipërisë nga Komisioni Shtetëror i PMV-ve.

4. Për të provuar se vaksinat e ofruara përmbushin specifikimet teknike të kërkuara, operatori ekonomik duhet të paraqesë skedë teknike/katalogun ose çdo dokument ekuivalent të produktit ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të dozës përkatëse.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mallrat e ofruara nga operatori ekonomik.

5. Operatori ekonomik të disponoje leje të tregtimit të produkteve mjekësore veterinarë me emërtimin “Tregtim me shumicë i barnave (për kafshë)”, kodi II.7.B.2, lëshuar nga QKB.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ligjin Nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pika 5/a e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar dhe në VKM Nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se janë të licencuar për tregtimin me shumicë të barnave për kafshë.

6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 1 (një) mjet transporti frigoriferik për transportin e vaksinave sipas kushteve të përcaktuara në specifikimet teknike, të cilin duhet ta ketë në pronësi / qira / përdorim.

Per mjetet e kërkuar duhet të paraqiten dokumentat si më poshtë:

- a) Nëse është në pronësi, të disponohet dokumenti certifikatë pronësie e mjetit, leje qarkullimi e vlefshme, çertifikata e kontrollit teknik e vlefshme, polica e vlefshme e sigurimit të detyrueshëm të mjetit.
- b) Nëse është me qira/ huapërdorje, të disponohet kontrata e qirasë/ huapërdorjes, leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik vlefshme, si dhe polica e vlefshme e sigurimit të detyrueshëm të mjetit si dhe foto të mjetit të dallueshme për përdorim transporti të dozave objekt prokurimi.

Shënim. *Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 5/ç të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë mjetin e nevojshëm për transportimin e vaksinave sipas parashikimeve të specifikimeve teknike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Loti 2: “Blerje e alergentëve tuberkulinë bovinë dhe aviare për kontrollin e tuberkulozit në gjedh për AKVMB-në” .

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, pika 2/a e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar *jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të lotit* është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*”.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024,2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.*

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet*”.

Referuar Nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:**
i)totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh**; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh**; iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar gjatë periudhës kontabël**”.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit të lotit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit të lotit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për

realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si vërtetime/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2. Operatori ekonomik, mund të jetë prodhues i artikujve objekt prokurimi. Në rast se nuk është prodhues, duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi. Në rastin e paraqitjes të kësaj të fundit duhet të paraqitet një dokument që vërteton lidhjen midis Distributorit dhe Prodhuesit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se janë prodhues ose kanë mundësinë të marrin mallin e ofruar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi. Gjithashtu nëpërmjet këtij kriteri operatorët ekonomikë dëshmojnë se ofrojnë një produkt origjinal të prodhuar sipas kërkesave të Komisionit Shtetëror të PMV-ve, bazuar në Ligjin Nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë të detajuar me të dhënat përkatëse të kompanisë prodhuese si emri tregtar, vendi i ushtrimit të aktivitetit, email etj, si dhe dokumentacion që konfirmon statusin ligjor/certifikatën e regjistrimit të prodhuesit, ku të specifikohet se certifikata e tregtimit, për dozat e vaksinës të ofruara, është lëshuar nga Agjencia Europiane e Medikamenteve (EMA) ose në një nga vendet e BE, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Neni 85, pika 3.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në republikën e Shqipërisë”, Kreu VII “Produktet mjeksore veterinare”, Seksioni 1 “Autorizimi për tregtimin e produkteve mjekësore veterinare”, Neni 85 “Tregtimi i produkteve mjekësore veterinare”, pika 3, ku përcaktohet:

“Komisioni Shtetëror i PMV-ve njeh dhe pranon certifikatën e tregtimit për PMV-të, lëshuar nga Agjencia Europiane e Medikamenteve (EMA) ose në një nga vendet e BE-së”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se do të ofrojnë një vaksinë e cila njihet dhe lejohet të tregëtohet në Republikën e Shqipërisë nga Komisioni Shtetëror i PMV-ve.

4. Për të provuar se vaksinat e ofruara përmbushin specifikimet teknike të kërkuara, operatori ekonomik duhet të paraqesë skedë teknike/katalogun ose çdo dokument ekuivalent të produktit ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të dozës përkatëse.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të

krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mallrat e ofruara nga operatori ekonomik.

5.Operatori ekonomik të disponoje leje të tregtimit të produkteve mjekësore veterinare me emërtimin “*Tregtim me shumice i barnave (për kafshë)*”, kodi II.7.B.2, lëshuar nga QKB.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar, ligjin Nr. 10465, datë 29.09.2011 “*Për shërbimin veterinar në republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, pika 5/a e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*” i ndryshuar dhe në VKM Nr. 538, datë 26.5.2009 “*Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta*” i ndryshuar.

6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 1 (një) mjet transporti frigoriferik për transportin e vaksinave sipas kushteve të përcaktuara në specifikimet teknike, të cilin duhet ta ketë në pronësi / qira / përdorim.

Per mjetet e kërkuar duhet të paraqiten dokumentat si më poshtë:

- a) Nëse është në pronësi, të disponohet dokumenti certifikatë pronësie e mjetit, leje qarkullimi e vlefshme, certifikata e kontrollit teknik e vlefshme, polica e vlefshme e sigurimit të detyrueshëm të mjetit.
- b) Nëse është me qira/ huapërdorje, të disponohet kontrata e qirasë/ huapërdorjes, leje qarkullimi, certifikata e kontrollit teknik vlefshme, si dhe polica e vlefshme e sigurimit të detyrueshëm të mjetit si dhe foto të mjetit të dallueshme për përdorim transporti të dozave objekt prokurimi.

Shënim. *Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 5/ç të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë mjetin e nevojshëm për transportimin e vaksinave sipas parashikimeve të specifikimeve teknike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar sipas standardeve ndërkombëtare, nga grupi i punës, ku në përbërje janë ekspertë të fushës.

Hartimi i specifikimeve teknike, është bërë në bazë të Ligjit nr. 10465, date 29.9.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, “Programit të kontrollit të sëmundjes së Plasjes”, rregullores Nr. 370, datë 29.7.2014, “Për miratimin e rregullores “Mbi Produktet Mjeksore Veterinare”, rregullores Nr. 429 /2016 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian përsa i përket menaxhimit, ruajtjes së rezevave të antigeneve”, dhe në manualin diagnostik të testeve dhe vaksinave nr. 12/2023, të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

NJËSIA E PROKURIMIT